

**TRANSLATION OF PROFESSIONAL TERMINOLOGY IN
TEXTBOOKS CASE STUDY: TEXTBOOKS FOR SECONDARY
SCHOOLS-ECONOMIC AND JURIDICAL PROFESSION
PËRKTHIMI I TERMINOLOGJISË PROFESIONALE NË TEKSTET
SHKOLLORE RAST STUDIMI: TEKSTET PËR SHKOLLAT E
MESME, DREJTIMI EKONOMIKO-JURIDIK**

Hana DARDHISHTA¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: hana.dardhishta@unite.edu.mk

Abstract

Based on the data and research in the field of translation in general, in the available materials, mainly in Albanian and Macedonian language, but also in other languages, in this paper I have tried to address the importance and problems of translation, especially on the translation of professional terminology in textbooks. Translation problems have been discussed in many meetings and discussions, seminars and conferences, and many papers have been published in various scientific journals, but the positive effect is still not noticed.

Because textbook translations are still full of omissions, in this paper we will focus on the issues of lexical and terminology in particular, not leaving aside other omissions (especially of untranslated parts or examples). This paper, however it is not comprehensive regarding the treatment about the problems of this theme or translation in general, but I hope that this approach serves as a reference for all those who are interested engage in the textbook translation process.

Keywords: *Textbooks, translation, professional terminology, language, dictionary.*

Përmbledhje

Duke u bazuar në të dhënat dhe hulumtimet në fushën e përkthimit në përgjithësi, sidomos në materialet në dispozicion, kryesisht në gjuhën shqipe dhe maqedonase, por edhe në gjuhë të tjera, në këtë punim do të trajtoj rëndësinë dhe problematikën e përkthimit, me theks të veçantë tek përkthimi i terminologjisë profesionale në tekstet shkollore. Për problemet e përkthimit është folur në shumë mbledhje e diskutime, seminare e konferenca, gjithashtu janë botuar edhe shumë kumtesa në revista të ndryshme shkencore, porse ende nuk vërehet efekti pozitiv.

Meqenëse përkthimet e teksteve shkollore ende janë plot e përplot lëshime, në këtë punim do të përqëndrohem në problematikën e rrafshit të leksikut dhe të terminologjisë në veçanti, duke mos lënë anash edhe lëshimet e tjera (sidomos të pjesëve apo shembujve të papërkthyer). Ky punim, megjithatë nuk është shterues lidhur me trajtimin rreth problematikave të kësaj teme apo të përkthimit në përgjithësi, por, shpresoj që kjo qasje të shërbejë si referencë për të gjithë ata që janë të interesuar të angazhohen në procesin e përkthimit të teksteve shkollore.

Fjalët kyçe: *Tekst shkollor, përkthim, terminologji profesionale, gjuhë, fjalor.*

Hyrje

Përkthimi është i një rëndësie tejet të madhe, ai duhet parë jo vetëm në aspektin gjuhësor, por edhe në aspektin kulturor, social e të tjera, pasi luan rol shumë të madh në edukimin, arsimimin dhe nxënien e njohurive të lëmive të ndryshme nga ana e nxënësve si në shkollat fillore ashtu edhe në shkollat e mesme, duke mos lënë anash edhe studentët (duke pasur parasysh që një numër i madh i tyre shfrytëzojnë literaturë të përkthyer të profesioneve të ndryshme). Për të pasur një përkthim cilësorë me theks të veçantë të terminologjisë profesionale, duhet të nxirren në pah si ngjashmëritë ashtu edhe ndryshimet ndërmjet tekstit burimor dhe gjuhës së synuar, kuptohet duke iu referuar edhe fjalorëve të ndryshëm.

Që të përkthehet një material në më shumë gjuhë, çdo herë duhet të fillohet nga gjuha burimore dhe jo të bëhet përkthimi nga një përkthim tjetër (nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase, dhe pastaj nga gjuha maqedonase në gjuhë të tjera). Duke dashur që përmbajtja e teksteve shkollore të jetë sa më cilësore dhe në hap me vendet e zhvilluara evropiane, Ministria e Arsimit dhe Shkencës u përpoq dhe mundësoi që në shkollat fillore dhe të mesme, për shumë lëndë mësimore të mund të përdoren tekste shkollore përkatëse të adaptuara nga jashtë sipas programeve mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) dhe të përkthyer në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në vendin tonë.

Qëllimi çdoherë ka qenë dhe është për të mirën e nxënësve apo të gjeneratave të reja, por nga ana tjetër si nxënësit, arsimtarët apo profesorët, prindërit, gjithashtu edhe institucionet u ballafaquan me problematika të përkthimit (që realisht nuk është se për herë të parë po përballeshin me këtë problematikë).

Trajtimi i çështjes

Duke pasur parasysh mënyrat apo prurjet e reja në arsim, e bashkë me këto edhe tekste të reja shkollore, si rrjedhojë po ballafaqohemi edhe me problematika të gjuhës së teksteve shkollore si rezultat të cilësisë së përkthimit. Kjo problematikë kërkon të trajtohet më hollësisht në ngritjen e nivelit cilësor të tyre. Është logjike të thuhet që përveç aftësive në përkthim që mund t'i posedojnë përkthyesit, ata kanë nevojë edhe për një nivel të caktuar njohurish apo përvojë rreth temës apo çështjes që mund të jetë si objekt i tekstit shkollor që ata përkthejnë.

Në natyrën e çdo përkthyesi fjala është shumë e rëndësishme në përkthim dhe të detyron të gjesht nuancën e caktuar, që të jetë e saktë dhe jo e përafërt, për të shprehur një mendim të caktuar. Pra, nuk mund të bëhet një përkthim cilësor, në cilëndo gjuhë, pa një terminologji të standardizuar të secilës fushë veçmas. E standardizimi i terminologjisë është punë që kërkon përkushtim dhe kohë për hartimin e fjalorëve të ndryshëm terminologjikë cilësor për secilën fushë. Megjithëse nuk është e domosdoshme që një përkthyes të jetë ekspert i një fushe, por që është e nevojshme që të ketë njohuri të mira mbi atë lëmi.

Duke u nisur nga kjo që thamë deri tani, do të thoja që qëllimi kryesor i këtij punimi është që:

- të nënvizojë nevojën e madhe për përkthyes mirë të trajnuar dhe ekspertë e njohës të fushave të ndryshme;
- të tregojë arsyet që përkthimi kërkon njohuri të posaçme meqë konsiderohet si proces i specializuar;
- të japë rekomandime për menaxhim sa më të mirë të procesit të përkthimit tek përkthyesit e rinj.

Posedimi i një lloj mjeshtrie apo aftësie e rishprehjes së materialit original është e domosdoshme për çdo përkthyes, do citoj fjalët e Xhevat Lloshit⁹⁵ ku thotë: “Përkthyesi është ambasadori nga një gjuhë në një tjetër, nga një kulturë në një tjetër; është përcjellësi i kumtit, që nuk ia shton fajet kumtit, por përkundrazi, përpiket me gjithë dijet dhe aftësitë e tij të përcjellë jo vetëm besnikërisht një përmbajtje, por edhe ta përcjellë atë me gjithë informacionin, me gjithë shijen dhe me vlerat estetike.” Arsyet që tregojnë qartë se përkthimi kërkon njohuri të posaçme, janë analizat e bëra mbi tekstet mësimore të cilat vënë në dukje seriozitetin e problemeve gjuhësore. Pra, vetë lëshimet apo problemet gjuhësore gjatë përkthimit të teksteve shkollore (sidomos ato profesionale, në rastin konkret për tekstet shkollore të drejtimit juridiko-ekonomik) bëjnë që nxënësit të ballafaqohen me të tilla vështirësi gjatë nxënies së njësive mësimore.

Sipas specialistëve të fushës, lëshimet vërehen që nga titujt e teksteve shkollore, e kjo mund të ketë ndodhur nga pakujdesia por edhe nga mosnjohja e fushës, si p. sh.: titulli i tekstit shkollor *Канцелариско работење* për vitin e IV të shkollave të mesme profesionale (mësimi i rregullt dhe zgjedhor), drejtimi ekonomiko-juridik dhe tregtar, profili teknik juridik, (Makedon Sllavkoski) në gjuhën shqipe është përkthyer *Puna në zyrë*, e që sipas specialistëve të fushës duhet të jetë *Punë zyre*. Gjithashtu edhe titulli i tekstit shkollor *Секретарско работење* për vitin e III të shkollave të mesme profesionale, drejtimi ekonomiko-juridik dhe tregtar, profili sekretar afarist, (Cërneska-Simovska, Vesna, Arsova-Andreska Suzana,) në gjuhën shqipe është përkthyer *Puna e sekretarisë*, e që sipas specialistëve të fushës duhet të jetë *Punë sekretarie*.

Në grupin e gabimeve gjuhësore, nuk janë analizuar gabimet e veçanta gramatikore, por analiza ka detektuar gabime të cilat i bëjnë fjalitë të pakuptimta, si dhe lëshime të tipit *fjalë të papërkthyer* apo *shembuj të papërkthyer*. Shumë e rëndësishme është që gjatë përkthimit të mos neglizhohet konteksti i fjalisë, me theks të veçantë përshtatja, modulimi, elementët e sintaksës së gjuhës burimore dhe procesit të përkthimit apo kalimit në gjuhën tjetër, sepse në të kundërt fjalia ka një shpjegim të paqartë, apo më mirë thënë është e vështirë të kapet a të kuptohet nga ana e nxënësit, pasi që nuk është e qartë, siç ndodh me fjalinë e dhënë në ilustrimin në vijim, por edhe te shembujt në vazhdim:

⁹⁵ Xhevat Lloshi, *Shkrime rreth përkthimit*, Shkup, 2020, f. 154.

- Shembulli i dhënë në ilustrimin 1.: «Janë plotësuar kushtet për regjistrimi i tregtarit-individual në pajtim ZTD kurse në bazë të fletëparaqitjes».

Të dhënat për subjektin e regjistrimit	1. Fletëparaqitja për regjistrim për gjykatën Janë plotësuar kushtet për regjistrimi i tregtarit-individual në pajtim ZTD kurse në bazë të fletëparaqitjes

VËREJTJE: Nëse ka më tepër dorëzues jepet lista me nënshkrim të dorëzuesve
Formulari nr. 3/3

Ilustrimi 1. Puna e sekretarisë për vitin e III, profesioni ekonomik, juridik dhe tregtar – sekretar afarist, faqe 48.

- Emërtimi i shkurtuar ZTD (Zakon za trgovski drustva) nuk është përkthyer fare, e që duhet të jetë LSHT (Ligji për shoqëritë tregtare).
- Formësimin i akteve (faqe 22)
- Dorëzimet përgatiten dhe dorëzuar me shkrim (faqe 44)
- Me deklaratën qytetarët zakonisht e shprehur mendimin, dëshirën etj. për çështje specifike...(faqe 58)
- Përshkruhen studimeve tuaja (faqe 151)
- Procesverbalet shkruhen me makinës së shkrimit ose kompjuter (faqe 211)
- Shembull i kërkesës për haje të xhiro-llogarisë (faqe 212)
- Fabrike zatekstil dhe konfeksionit “Oteks” Ohër (faqe 288).

Sa u përket shembujve që nuk janë të përkthyer, pra që janë në gjuhën maqedonase, (madje edhe i tërë shembulli) rastet e tilla janë të shumta, por ne do të mundohemi disa prej tyre t'i paraqesim si në vijim:

- Shembulli i zarfit (faqe 27)
- Shembulli rreth temës së shkrimit të akteve apo më saktë distanca për shkrimin e akteve (letra), që i ndihmon nxënësit në orët e ushtrimeve gjatë të shkruarit të letrës (faqe 29)
- Shembulli i distancave të aktit – forma evropiane (faqe 34)
- Shembulli i letrës – forma evropiane (faqe 35, faqe 39)
- Shembulli i kërkesës për sigurim dhe krijim të marrëdhënies së punës – formular (faqe 162)
- Shembulli për evidencën e rrogave (faqe 168-170)
- Shembujt e kryetitullit të letrës afariste (faqe 248-249)
- Shembujt e adresimit të zarfeve (faqe 253-254)
- Shembulli i porosisë dhe deklaratës (faqe 295)
- Shembulli i mbylljes së kontratës - formulari (faqe 304)
- Shembulli i dërgesës – formulari (faqe 305)
- Shembulli i faturës – formulari (faqe 307)
- Shembulli i fletëpranimit – formulari (faqe 308)

• Shembulli i dhënë nga sistemi elektronik i furnizimeve publike, fig. 6 –Kërkesa për mbledhje të ofertës (shpalljeve) (faqe 366) si dhe fig. 7 –Formulari për regjistrimin e furnizuesve (faqe 367).

Shembulli në vijim siç shihet i papërkthyer fare, është marrë nga teksti shkollor *Statistika* për vitin e III, drejtimi ekonomik-juridik dhe tregtar, profili teknik i ekonomisë (Standkovska & Jolevska 2010: 25), më saktësisht Ilustrimi 2:

TEMA E OJTË: METODAT E STUDIMIT TË STATISTIKËS

Tabela numër 2.2: Raporti prej bursës së Maqedonisë AD Shkupi

МАКЕДОНСКА БЕРТА АД СКОПЈЕ
МЕСЕЧЕН СТАТИСТИЧКИ БИЛТЕН
 Јануари 2010

Показател	Декември 2009	Јануари 2010	Промена
БЕРЗАНСКИ ПОКАЗАТЕЛИ			
ПРОМЕТ (денари)			
Класично тргување	234.859.559	204.651.933	-10,31
Оверенци	127.154.142	130.274.297	2,46
Трансакции преку директен промет (денари)	37.832.747	60.097.436	57,90
Трансакции преку директен број на трансакции	11.175.500	12.034.251	7,64
Вкупно трансакции	22.081.693	103	-99,53
Јавни берзански аукциони	23.927.859	-	-
ВКУПНО	285.996.451	204.951.933	-29,02
БРОЈ НА ТРАНСАКЦИИ			
Класично тргување	2.429	1.751	-27,54
Вкупно трансакции	2	-	-
Јавни берзански аукциони	15	-	-
ВКУПНО	2.444	1.751	-28,36
ПАЗАРНА КАПИТАЛИЗАЦИЈА (денари)			
ПАЗАРНА КАПИТАЛИЗАЦИЈА НА АКЦИИ	122.080.078.889	125.150.555.993	2,54
Оверизирање пазар акци	28.825.704.303	30.473.732.400	5,73
ПАЗАР НА АКЦИОНЕРСКИ ДРУШТВА СО ПОСЕБЕН ОВЕРСКИ ЗА ИЗВЕШТУВАЊЕ	93.154.312.396	94.676.823.593	1,62
ПАЗАРНА КАПИТАЛИЗАЦИЈА НА ОВЕРЕНЦИ	14.883.330.548	14.999.793.291	0,78
ВКУПНО ПАЗАРНА КАПИТАЛИЗАЦИЈА	136.963.407.036	140.268.156.684	2,39
МЕНИ			
МЕНИ	2.751.24	2.544.93	-7,26
ОМБ	3.038.98	5.101.91	67,83
ОМБ	110.08	110.08	0,00
БРОЈ НА КОТРАНИ ДРУШТВА	36	36	0,00
БРОЈ НА ДЕНОВИ НА ТРГУВАЊЕ	21	17	-19,05

Извор: www.mse.org.mk

2. METODA E MBIKËQYRJES E NJË PJESE TË MASËS STATISTIKORE

Ilustrimi 2. Statistika për vitin e III, faqe 25.

Arsyet që tregojnë qartë se përkthimi kërkon njohuri të posaçme janë vetë lëshimet e gabimet, për të cilat kanë reaguar edhe arsimtarët⁹⁶ e lëndëve përkatëse. Tani, po t'i marrim dhe studiojmë më seriozisht dhe më thellësisht tekstet shkollore, do të vërejmë, se disa fjalë të përkthyer nuk i përgjigjen fare origjinalitetit të gjuhës shqipe. Pra, duhet të kemi parasysh edhe faktin që gjatë përkthimit të teksteve shumë shprehje apo fjalë përkthehen në atë mënyrë që gjuha shqipe nuk i njeh si fjalë adekuate, dmth nuk është fjala që përputhet plotësisht me diçka tjetër, që i përshtatet a që i përgjigjet plotësisht diçkaje tjetër, siç kemi shembullin⁹⁷ në vijim, ilustrimi 3:



Ilustrimi 3. Puna e sekretarisë për vitin e III, f. 95.

⁹⁶ Realizimi i një ankete të bërë nga vetë autori me disa arsimtarë të shkollave të mesme, kryesisht nga qyteti i Shkupit, tregon që ka mjaft vërejtje për përkthimet e teksteve shkollore (e realizuar gjatë muajve shtator-tetor, të vitit 2021).

⁹⁷ Čerņeska-Simovska, Vesna, Arsova-Andreska Suzana, Puna e sekretarisë për vitin e III, profesioni ekonomik, juridik dhe tregtar – sekretar afarist, Shkup, 2010, f. 95.

Siç shohim, përkthimi thotë «lajmërimi i vdekjes bëhet nga anëtarët e familjes...», e që në gjuhën shqipe do të duhej të ishte «deklarimi i vdekjes bëhet nga anëtarët e familjes...» apo «paraqitja e vdekjes bëhet nga anëtarët e familjes...» e kursesi «lajmërimi ...». Nga përkthime të tilla aty për aty duhet pasur kujdes, sepse te gjeneratat e reja mund të ngulitet një shprehje e gabuar dhe kështu mund të zë vend në të folurën tonë dhe për më tepër edhe të konsiderohet e përshtatshme për gjuhën tonë.

Përfundimi

Shembujt e mësipërm ishin mjaftueshëm sa për të paraqitur një pasqyrë të gjendjes me tekstet shkollore në këto drejtime, por që edhe në drejtimit e tjera nuk jemi më mirë me çështjen e përkthimeve. Sa i përket rekomandimeve për menaxhim sa më të mirë të procesit të përkthimit tek përkthyesit e rinj, do të duhet një kujdes i posaçëm gjatë përkthimit të fjalëve të specializuara të ligjeve dhe rregulloreve, të biznesit dhe financave, me qëllim që të ketë sa më shumë rritje të burimeve terminologjike nga ana e përkthyesit. E rëndësishme është që të kemi një përkthim sa më të saktë të mundshëm, duke respektuar edhe rregullat e drejtshkrimit e të pikësimit të gjuhës shqipe, e për këtë, si referenca duhet përdorë edhe fjalorët e gjuhës së sotme shqipe.

Gjithashtu, vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet terminologjisë në këtë rast juridiko-ekonomik, por duke mos lënë anash edhe terminologjitë e tjera. Në botën ligjore, secili term bën një ndryshim, prandaj është e nevojshme që të mësojmë të dallojmë fjalët adekuate (të dallojmë disa fjalë nga të tjerat) pasi që një term i vetëm mund të jetë vendimtar në një traditë juridike. Për të dorëzuar një shërbim më të saktë dhe më të besueshëm të përkthimit, përkthyesi duhet të jetë më me përvojë dhe i kualifikuar në fushën e tij, p. sh. përvoja e së drejtës apo e finansave etj. e rëndësishme është që të interpretohet kuptimi, si dhe fjalët që të kemi një përkthim më të saktë të mundshëm. Gjithashtu, një përkthyes duhet të dijë mirë edhe rregullat e drejtshkrimit e të pikësimit të gjuhës shqipe, e për këtë, si referenca duhet të përdorë edhe fjalorët e gjuhës së sotme shqipe. Ky punim, apo kjo temë është trajtuar me dëshirën jo për të kritikuar, por për të trajtuar si çështje dhe njëkohësisht për të siguruar përkthim cilësor me një përgjegjësi më të madhe në këtë fushë.

Referencat

- [1]. *Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980.
- [2]. Lafe E., Caka N., Duro A., Rizaj M., punim studimor *Terminologjia profesionale si veprimtari ndërdisiplinore dhe detyrat e Alb-shkencës*, nr. 3-4, Shkup, 2014.
- [3]. Lyons, John, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë, 2001.
- [4]. Lloshi, Xhevat, *Shkrime rreth përkthimit*, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, Shkup, 2020.
- [5]. *Fjalor juridik*, Akademia e Drejtësisë së Kosovës, Prishtinë, 2019.
- [6]. https://www.academia.edu/2108309/More_than_one_language_in_the_brain
- [7]. Standkovska, Suzana, Jolevska, Evica, *Statistika*, Shkup, 2010.
- [8]. Sllavkoski, Makedon, *Puna në zyrë për vitin e IV*, drejtimi ekonomik, juridik dhe tregtar – teknik juridik, Shkup, 2013.
- [9]. Sllavkoski, Makedon, *Puna e sekretarisë për vitin e II*, drejtimi ekonomiko-juridik dhe tregtar – sekretar afarist, Shkup, 2010.
- [10]. Čerņeska-Simovska, Vesna, Arsova-Andreska Suzana, *Puna e sekretarisë për vitin e III*, profesioni ekonomik, juridik dhe tregtar – sekretar afarist, Shkup, 2010.
- [11]. www.e-ucebnici.mon.gov.mk